

## **AKTI I THEMELIMIT I SHOQËRISË 1T GROUP Shpk**

Sot, në Tiranë, më 28.04.2023 në përputhje me kriteret e Ligjit nr. 9901 datë 14.04.2008, "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", i ndryshuar, u hartua ky Akt Themelimi i Shoqërisë me përgjegjësi të kufizuara me ortak themelues:

**Granit Gojani**, shtetas Kosovar, i ditelindjes 05.05.1989, i pajisur me pasaporte P01449658 i cili vendosi të hartojnë këtë Akt Themelimi të Shoqërisë **1T GROUP Shpk** në bazë të Ligjit 9901 datë 14.04.2008, "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", i ndryshuar, të ligjit 9723 datë 03.05.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit", i ndryshuar, Kodit Doganor, Kodit Fiskal, si vijon:

### **KAPITULLI 1**

#### **Neni 1** **Themelimi**

Shoqëria **1T GROUP Shpk** është person juridik i të drejtës juridike shqiptare, shoqëri me përgjegjësi të kufizuar (këtu në vijim do të referohet si "Shoqëria").

#### **Neni 2**

##### **Personaliteti Juridik**

Shoqëria përfiton personalitetin juridik pas regjistrimit në Qendrën e Regjistrimit të Kompanive sipas kërkesave dhe procedurave që parashikon Ligji.

Shoqëria, pasi përfiton personalitetin juridik, është përgjegjëse kundrejt palëve të treta për detyrimet dhe dëmet e shkaktuara gjatë ushtrimit të aktivitetit të saj.

Shoqëria **1T GROUP Shpk** është një shoqëri, e themeluar midis ortakëve që u përgjigjen humbjeve deri në limitin e vlerës së kontribuar në kapitalin e shoqërisë.

#### **Neni 3**

##### **Selia**

Shoqëria ka selinë në Tiranë, Autostrada Tirane - Durrës, km.6, 1000, brenda ambienteve të QTU -se. Shoqëria mund të ndryshojë selinë e saj, mund të hapë zyra përfaqësie, filiale, mund të krijojë degë si brenda ashtu edhe jashtë Republikës së Shqipërisë, vetëm me Vendim të Asamblesë së Përgjithshme.

#### **Neni 4** **Objekt i aktivitetit**

Objekti i veprimtarisë së shoqërisë:

Punime montimi nga druri dhe materiale të tjera. Aktivitetet e ndërmjetësimit për shitjen e lëndës së drurit dhe materialeve të ndërtimit. Sharrimi i drurit dhe zdrukthetaria. Prodhimi i kontinierëve nga druri. Prodhimi i produkteve të tiera nga



druri; artikujve nga tapa, kashta dhe materialeve thurëse. Tregtia me shumice jo e specializuar. Aktivitetet e ndermjetësimit për shitjen e nje shumëllojshmërie mallrash. Aktivitetet e ndermjetësimit për shitjen e mobilieve, mallrave shtepiake, pjesëve elektronike dhe hekurishteve. Aktivitetet e ndermjetësimit të specializuar për shitjen e produkteve të veçanta. Prodhimi dhe tregtimi i materialeve të ndertimit. Aktivitetet në fushën e ndertimit, objekte të ndryshme rezidenciale dhe jo rezidenciale, etj. Rikonstruksione të ndryshme. Organizimi dhe realizimi i panairëve dhe ekspozitave për muzetë dhe çdo promovim eventual i nevojshëm për importet-eksportet e produkteve tipike dhe lëndëve të para të çdo vendi të interesuar në projektet e tregtisë dhe shqembimit të mallrave me vendet e tjera. Prodhim dhe tregtim, artikuj të ndryshëm industriale. Import-Export dhe tregtim, artikuj të ndryshëm konfensionesh, kerpi, lini, etj. të perfuduara dhe gjysem të perfuduara. Import-Export dhe tregtim, materiale plastike të llojeve dhe formave të ndryshme; Blerje dhe tregtim, automjete të ndryshme, të personalizuar për transportin e njerezve dhe mallrave për linja kombetare dhe nderkombetare. Zyre imobiliare, etj.

### **Neni 5**

#### **Kohëzgjatja**

Kohëzgjatja e aktivitetit të Shoqërisë **IT GROUP** është pa afat.

## **KAPITULLI 2**

### **KAPITALI**

#### **Neni 6**

#### **Kapitali themeltar**

Kapitali themeltar i shoqërisë është 100000 (njqind mijë) lek i ndare në 1 kuote. I cili zoterohet nga ortakut i vetëm **Granit Gojani**

Pjesët e kapitalit themeltar nuk mund të përfaqësohen nga vlera të tregtueshme.


Kontributi i ortakëve mund të derdhet në para ose në natyrë (pasuri të luajtshme/pasuri të paluajtshme ose të drejta).

Ortakët që cënohen të ushtrojnë të drejtat që rrjedhin nga zotërimi i pjesës në shoqëri, kanë të drejtë të kërkojnë nga gjykata urdhër ndalimin e shkeljes ose shpërblimin e dëmit të shkaktuar si pasojë e cenimit të këtyre të drejtave. Kjo e drejtë ushtrohet brenda 3 viteve nga momenti i shkeljes.

#### **Neni 7**

#### **Mënyra e transferimit të kapitalit**

Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar dhe të drejtat që rrjedhin prej saj mund të blihen ose transferohen nëpërmjet:

- a) kontributit në kapitalin e shoqërisë,
  - b) shitjes,
  - c) trashëgimisë,
  - d) dhurimit,
  - e) çdo mënyrë tjetër të parashikuar nga ligji.
- 



Në rastin e kalimit të aksioneve me kontratë, kjo kontratë duhet të bëhet me shkrim.

~~Statuti mund ta kushtëzojë transferimin e kuotave, veçanërisht duke përcaktuar miratimin ose të drejtën e parablerjes së shoqërisë në favor të shoqërisë ose ortakëve të tjerë.~~

Në rastin e transferimit të kuotave me kontratë, afatet dhe kushtet e transferimit të titullit të kuotës, si dhe kushtet e tjera kalimtare, duke përfshirë pagesën për blerjen e kuotave, rregullohen nga kontrata. Kontrata për transferimin e kuotave hartohet me shkrim dhe noterizimi nuk është kusht për vlefshmërinë ose regjistrimin e kontratës. Me përjashtim të rasteve të parashikuara shprehimisht në ligj ose kur palët bien dakord për një kontratë, vlefshmëria, e së cilës, për kalimin e titullit të pronësisë mbi kuotat, nuk i nënshtrohet procedurave administrative të ndryshme me efekt deklarues, përfshirë këtu edhe procedurat e regjistrimit ose publikimit të kontratës ose transferimit të titullit.

### KAPITULLI III ORGANET VENDIMMARRËSE DHE MENAXHUESE

#### Neni 8 Organi i Vendimmarrjes

Asambleja e Ortakëve është i vetmi organ vendimmarrës në Shoqëri.  
Asambleja e Ortakëve është organi i vetëm vendimmarrës i shoqërisë që miraton ndryshimet në statut sipas procedurave të përcaktuara në ligj.  
Asambleja e Përgjithshme është përgjegjëse për vendimet e marra nga shoqëria për sa vijon:

- a. përcaktimi i politikave tregtare të shoqërisë;
- b. ndryshimet statutores;
- c. emërimi dhe shkarkimin e Administratorëve;
- ç. emërimi dhe shkarkimin e likuidatorëve dhe e ekspertëve kontabël të autorizuar;
- d. përcaktimi dhe shpërblimi i personave të cituar në gërmat "c" e "ç" të kësaj pike;
- dh. mbikëqyrja mbi zbatimin e politikave tregtare nga ana e Administratorëve, duke përfshirë përgatitjen e bilanceve vjetore dhe raportet mbi progresin e biznesit;
- e. miratim të bilanceve vjetore dhe raporteve mbi progresin e biznesit;
- f. rritje dhe zvogëlim të kapitalit;
- g. ndarja e kuotave si dhe anulimi i tyre;
- h. përfaqësimi i shoqërisë në gjykim dhe procedime të tjera kundrejt Administratorëve;
- i. riorganizim dhe shpërbërje të shoqërisë;
- j. miratimi i rregullave procedurale për mbledhjet e Asamblesë;
- k. kërkojë kredi pranë çdo banke ose institucioni financiar.
- l. Çështje të tjera të parashikuara në ligj ose në Statut.

Ortakët mund të përfaqësohen në Asamblenë e Përgjithshme, nga një ortak tjetër ose nga një palë e tretë me anë të një autorizimi.

Drejtori i shoqërisë nuk mund të veprojë si përfaqësues i ortakëve në Asamblenë e Përgjithshme.

Autorizimi mund të jepet vetëm për pjesëmarrje në një mbledhje të Asamblesë së Përgjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet e ardhshme që do të kenë të njëjtin rend dite.



## **Neni 9** **Administrimi**

**Granit Gojani**, shtetas Kosovar, i ditelindjes 05.05.1989, i pajisur me pasaporte P01449658, per 5 vjet.

Asambleja e përgjithshme mund ti shkarkojë administratorët në çdo kohë kur arrihet shumica. Statuti ose marrëveshje të tjera nuk mund ta përjashtojnë ose kufizojnë këtë të drejtë.

Gjithashtu, Administratorët shkarkohen nga gjykata për shkelje të ligjit me kërkesë të njërit prej ortakëve.

Të drejtat e përfaqësimit të Administratorëve dhe çdo ndryshim i tyre duhet të njoftohen për regjistrim në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.

Emërimi i administratorëve hyn në fuqi pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.

Administrator i shoqërisë mund të emërohet edhe një person, jo ortak.

## **Neni 10** **Kompetencat**

Administratori autorizohet dhe ka detyrimin të:

a) kryejë të gjitha operacionet e administrimit të aktivitetit tregtar, duke aplikuar politikat tregtare të caktuara nga Asambleja e Përgjithshme;

b) përfaqësojë shoqërinë tregtare.

c) ofrojë asistencë për mirëmbajtjen e saktë dhe të rregullt të dokumenteve dhe librave kontabël të shoqërisë.

ç) hartojë dhe nënshkruajë pasqyrat financiare vjetore, pasqyrat financiare të konsoliduara dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve dhe ia dorëzon këto dokumente Asamblesë së Përgjithshme për miratim;

d) të krijojë një sistem paralajmërimi për rrethanat që kërcënojnë mbarëvajtjen e biznesit dhe ekzistencën e kompanisë.

dh) kryejë regjistrimet dhe dërgojë të dhënat e detyrueshme për shoqërinë, sipas ligjit pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit.

e) raportojë së pari para Asamblesë së Përgjithshme për zbatimin e politikave tregtare dhe zbatimin e veprimeve specifike me rëndësi të veçantë për biznesin e shoqërisë tregtare.

ë) kryejë detyra të tjera të përcaktuara nga ligji dhe Statuti.

Administratori ka të drejtë të kryejë të gjitha veprimet e zakonshme të menaxhimit. Administratori përfaqëson shoqërinë përpara të gjithë personave fizikë dhe juridikë, autoriteteve publike dhe/ose private, vendase ose të huaja, shqiptare ose të huaja, përfshirë autoritetet gjyqësore të të gjitha niveleve, bankat e të gjitha niveleve, etj. Administratori ka kompetencë të veprojë në marrëdhënie me të tretët për llogari të shoqërisë, si dhe para bankave të të gjitha niveleve, të kryejë transferta, tërheqje etj., pranë zyrave të tatimeve, zyrave të administratës vendore, punës, doganave, autoritetet etj. në të gjitha rrethanat, me përjashtim të kompetencave që ligji u jep shprehimisht ortakëve të shoqërisë.

Administratori e përfshin shoqërinë në marrëdhënie me të tretët nëpërmjet akteve në përputhje me objektin e tij të veprimtarisë.



**Neni 11**  
**Viti Fiskal**

Viti financiar i kompanisë fillon më 1 janar dhe përfundon më 31 dhjetor. Me përjashtim të vitit të parë financiar i cili fillon në datën e regjistrimit të shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit dhe përfundon më 31 Dhjetor.

**Neni 12**  
**Baza Ligjore**

Shoqëria do të kryejë veprimtarinë e saj në përputhje të plotë me këtë Akt Themelimi dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.

Për gjithçka që nuk parashikohet në këtë akt, zbatohen dispozitat e ligjit "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", të Kodit Civil dhe të çdo ligji tjetër specifik në Republikën e Shqipërisë.

**Neni 13**  
**Mosmarrëveshjet**

Për të gjitha mosmarrëveshjet që mund të lindin gjatë zbatimit dhe interpretimit të këtij akti themelues, si dhe për mosmarrëveshjet e tjera që mund të lindin ndërmjet shoqërisë dhe të tretëve, kompetente do të jetë Gjykata Shqiptare.

**Neni 14**  
**Dispozitat përfundimtare**

Ky Akt Themelimi është hartuar në 4 kopje me të njëjtën vlerë ligjore, në shqip dhe është miratuar nga ortaku i shoqërisë tregtare **1T GROUP Shpk , z.Granit Gojani** dhe është nënshkruar në të gjitha kopjet duke shkruar emrin, mbiemrin, dhe firmën origjinale.

**ORTAKET THEMELUES**

**TE SHOQËRISË**

**1T GROUP Shpk**

**Granit Gojani**

Granit Gojani  
